

Pergjigje No.4

- 1- A është në dijeni AKEP për sa i përket rritjes së tarifës nga ana e kompanive celulare për afatin e skadimit të një numri me parapagesë (vlefshmërinë e rimbushjeve)? Nëse po, a do merret ndonjë masë ndaj kompanive celulare?

AKEP bazuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si edhe aktet rregullatore aktuale të nxjerra në zbatim të tij ka për kompetencë të rregullojë tarifën e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike. Tarifën e shërbimeve të komunikimeve elektronike vendosen nga sipërmarresit dhe qëllimi i rregullimit të tyre është parandalimi i sjelleve antikonkurruese dhe mbrojtja e konsumatorëve.

Vlefshmëria dhe kohëzgjatja e kartave celulare SIM me parapagesë, vendosjes së limitit të vlerës së rimbushjes, dhe afatet përkatëse nuk janë të rregulluara nga ligji nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si edhe aktet rregullatore aktuale të nxjerra në zbatim të tij.

Kuadri ligjor dhe rregullator i komunikimeve elektronike në Shqipëri është i bazuar në direktivat përkatëse të BE-së, dhe nga shqyrtimi i praktikave më të mira në vendet e BE-së dhe rajonit rezulton se afati i vlefshmërisë së rimbushjeve të kartave SIM përcaktohet nga secili operator celular në baze të politikave të tij tregtare, dhe nuk është objekt i rregullimit nga kuadri ligjor apo nënligjor përkatës i komunikimeve elektronike në këto vende.

Lidhur me shqetësimin e ngritur për këtë çështje, AKEP inkurajon shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve, si edhe të gjitha palët e interesuara për këtë çështje, për të gjetur ekuilibrat bazuar në praktikën më të mirë tregtare, në rajonin e më gjerë si dhe në bashkëpunim të ngushtë me operatorët celularë të identifikojnë mekanizmat e duhura për vendosjen e një kohëzgjatje të arsyeshme sa i përket vlefshmërisë së kartave SIM.

- 2- Tre kompanitë celulare, kanë tarifën të ndryshme sa i përket afatit të skadimit të një numri me parapagesë (vlefshmërinë e rimbushjeve): A ka një cmim tavan ose ndonjë detyrim ligjor që ua ndalon ta bëjnë këtë?

Sikurse u sqarua edhe më sipër, AKEP nuk ka kompetencë ligjore të rregullojë afatin e vlefshmërisë së kartave SIM, dhe atë me pak të përcaktojë cmime apo tarifën tavan.